



Department Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale
Uprava za zdravstvai Socialnog blagostanja
of Health & Social Services
p.n

nfo.ferizaj@rks-gov.net
Tel / Fax: 038/200-46035
Adresa: "Dëshmorët e Kombit"

PLANI I PUNËS :

Plani i punës për periudhën 01 Janar 2025 – 31 Dhjetor 2025

Emri dhe mbiemri i punëtorit : Vedat Hoxha

Titulli i punës: Udhëheqës i Shtëpisë së Komunitetit në Ferizaj

Raporton te : Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Orari i plotë : 40 orë në javë

Përfundimet (Përqendrimet) kryesore (s'paku 10 pika)

- 1. Respektimi i orarit te punes, disciplina ne punë zbatimi i te gjitha detyrave dhe obligimeve te përshkruara sipas kontratës dhe vendit te punes për të gjithë stafin e kësaj shtëpie.**
- 2. Planifikimi dhe organizimi i punës :Sigurimi i mirëqenies sociale dhe shëndetësore për të gjithë rezidentët e vendosur në institucionin, përgatitja e plan – programit të punës për secilin rezident për një mirëqenie të dinjitetëshme, sigurimi i një ambienti të qetë dhe të përshatshëm dhe avancimi i të drejtave dhe lirive të këtyre personave me aftësi të kufizuara mendore.**
- 3. Përcjellja e vazhdueshme e realizimit të detyrave të punës për stafin punues : gjendja shëndetësore dhe emocionale të rezidentëve ,kontrollimet e rregullta mjekësore (infektologu, neuropsikiatri, internisti, gjinekologu, pulmologu, stomatologu, analizat laboratorike, caktimi i grupeve të gjakut për të gjithë rezidentët) dhe qdo trajtim tjetër i nevojshëm mjekësorë, përcjellja për një ushqim të rregullt dhe kualitativ, për një hixhene të gjithëmbarshme dhe një jetë të dinjitetëshme .**
- 4. Furnizimi me kohë për të gjitha nevojat e parapara për këtë shtëpi, duke u nisur nga ushqimi, hixhena, medikamentet, nafta për ngrohje, veturë , gjenerator , servisimet e ndryshme dhe mirëmbajtëja e gjithë stabilimenteve dhe inventarit të shtëpise në gjendje funksionale.**
- 5. Bashkëpunimi me QPS –e prej nga vijnë rezidentët , bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve rreth nevojave të rezidentëve. Bashkëpunimi me institucionet shëndetësore si në komunë dhe në regjiont për ofrimin e shërbimeve të nevojshme shëndetësore për rezidentët. Bashkëpunimi me organet komunale, organizatat qeveritare dhe jo qeveritare dhe thithja e ndonjë donacioni të mundshëm me qëllim të përmirësimit të standardit sa më të mirë për rezidentët.**
- 6. Organizimi i aktiviteteve të lira dhe puna okupuese për rezidentët. Do të veprojmë me aktivitetet jashta institucionit si psh ; ekskurzionet, rehabilitimet,pik-niqet . Organizimet dhe aktivitetet ditore : në natyrë, lojëra,shetitje, , gjimnastikë,vallëzim,muzikë, vizatim etj.**

7. Raportimi dhe informimi me kohë te Drejtori/ja e DSHMS në kuadër të komunës, raportimi në DPSF dhe DAKPM në Prishtinë. .
Roportimi i rregulltë javorë, mujorë, gjashtmuor dhe vjetorë për punën e bërë dhe komunikimi i vazhdushëm me bazën dhe ministrinë gjegjëse për gjithë punën, problemet dhe vështërsitë e mundëshme etj.
8. Planifikimi i buxhetit dhe menaxhimi i tijë: Përcjellja dhe e videntimi i të gjitha të hyrjeve dhe dalëjeve brenda institucionit , evidentimi i tyre , raportimi në bazë.
9. Puna administrative : Përgatitja e kërkesave të ndryshme për furnizime- tenderime të ndryshme , kërkesa për servisime , mbajtja e raporteve të punës, raporte mbi komunalitë , raporte mbi shpenzimet mbrenda institucionit, (ushqim, hixhenë, barëna, mirëmbajtje , furnizime) etj.
10. Punë dhe obligime tjera të cilat mund të paraqitën gjatë punës sonë të përditëshme, varësishtë prej nevojave të rezidentëve.
11. Puna me zyren e prokurimit, zyrën e financave për furnizimet, tenderimin e të gjitha kërkesave të nevojshme për institucionin dhe përcjellja dhe menaxhimi i këtyre kontratave të ndryshme .
12. Punë të tjera : Mendojmë të realizojmë edhe punë të tjera sipas nevojave momentale dhe situatave te ndryshme te cilat mund te ndodhin gjate punes sone.
Si prioritet do te kemi mbrojtjen dhe përkujdesjen e rezidentëve nga sëmundjet epidemiologjike .

Rezultatet e pritshme:

Shpresojë se ky vit do të jetë edhe më i frytshëm dhe do të arrihen qëllimet dhe synimet e planifikuara, Duke patur parasyshë përvojën tonë të cilën e kemi arriur gjerë më tani.Mendojmë se me një angazhim dhe përkushtim të shtuar të gjithë stafit do të realizojmë planin e paraparë për vitin 2025.

Plani i zhvillimit:

Ky plan parasheh periudhën prej 01.01.2025 e deri më 31.12.2025

Komentet: _____

Nënshkruar nga Drejtori/ja i/e DSHMS-së :

Nënshkruar nga Udhëheqësi: i SHBKF-së:

/ Dr. Kemail Emini /

/ Vedat Hoxha /

Datë: _____